

32.640

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA RRETHIT TIRANE
NR. 32'640 VEND.

V E N D I M
PER REGJISTRIMIN E SHOQERISE "ALBAKONTROLL" SHPK
SI PERSON JURIDIK NE REGJISTRIN TREGTAR.

Sot, me dt. 14/12/2004, une gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen bashke me dokumentacionin perkates te paraqitur nga Administratori i shoqerise "ALBAKONTROLL" SHPK, Alban Shehri dhe,

K O N S T A T O V A

Se, shoqeria "ALBAKONTROLL" Shpk, eshte e themeluar nga Ortaket, Z. Alban Shehri, I cili eshte zoterues me 50 % te kapitalit themeltar dhe Z. Bujar Frangu, I cili eshte zoterues me 50 % te kapitalit themeltar. Se kapitali themeltar I kesaj shoqerie eshte 100.000 leke dhe I shlyer teresisht, se shoqeria ka si administrator te vetem z. Alban Shehri, I biri I Fehmiut, lindur ne Tirane, me 16.02.1971, me adrese banimi, Rr.H. Kolli, Pallati Frateri, Ap. 9A, Tirane, me Pashaporte Nr. 1996980, se kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjete, me seli ne qytetin e Tiranes me adrese Rr.H. Kolli, Pallati Frateri, Ap. 9A, Tirane dhe, se objekti veprimtarise se shoqerise eshte Agjensi doganore, agjensi spedicionere dhe transporti, agjensi turistike, sherbim postar express, kontroll sasior dhe cilesor te mallrave, marrje perpunim mostrash, kryerje analizash kimiko-fizike, kontroll te pershtatshmerisese mjeteve te transportit magazinave dhe depove te magazinimit, kontroll amballazhi, marketimi, etiketimi dhe stivimi te mallrave.

Dokumentacioni I paraqitur nga Administratori per regjistrimin si person juridik ne Regjistrin Tregtar te shoqerise "ALBAKONTROLL"shpk eshte i drejte dhe i bazuar ne ligjin nr.7638 dt.19.11.1992, "Per shoqerite tregtare" e ne kushte te tilla duhet pranuar.

PER KETE ARESYE

Ne baze te ligjes nr.7638 dt.19.11.1992 dhe ligjes nr.7667 date 28.01.1993.

V E N D O S A

Regjistrimin si person juridik ne Regjistrin Tregtar, shoqerine "ALBAKONTROLL"shpk e themeluar nga Ortaket, Alban Shehri, zoterues me 50 % te kapitalit themeltar dhe Z. Bujar Frangu, zoterues me 50 % te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie,

Se shoqeria eshte :


- me kapital themeltar 100.000 leke te shlyer teresisht nga ortaket e shoqeris;
- me administrator te vetem z.Alban Shehri, I biri I Fehmiut, lindur ne Tirane, me 16.02.1971, me adrese banimi, Rr.H. Kolli, Pallati Frateri, Ap. 9A, Tirane, me Pashaporte Nr. 1996980
- me kohezgjatje mbi 10 vjete;
- me seli ne qytetin e Tiranes me adrese Rr.H. Kolli, Pallati Frateri, Ap. 9A, Tirane;
- me objekt veprimtarie:

Hapjen e agjensive doganore, agjensi spedicionere dhe transporti, agjensi turistike, sherbim postar express, kontroll sasior dhe cilesor te mallrave, marrje perpunim mostrash, kryerje analizash kimiko-fizike, kontroll te pershtatshmerisese mjeteve te transportit magazinave dhe depove te magazinimit, kontroll amballazhi, marketimi, etiketimi dhe stivimi te mallrave.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit.

Tirane me 14 /12 /2004

GJYQTARE



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

Nr. _____ vendimi

32640/1

VENDIM
I GJYQTARES SE VETME

Ne Tirane, sot me date 27/11/2006 unë Gjyqtarja Enkela Bajo prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, shqyrtova kerkesen dhe aktet e paraqitura per shqyrtim nga shoqeria "ALBAKONTROLL" shpk dhe

KONSTATOVA:

Se me vendimin nr.32640 adte 24.12.2004 eshte rregjistruar si person juridik shoqeria "ALBAKONTROLL" shpk.

Me vendimin nr.1 date 07.11.2006 te asamblese se ortakeve te kesaj shoqerie shte vendosur:

Shitja e 25% te kuotave te kapitalit themeltar te njerit prej ortakeve te saj z.Bujar Frangu te shtetasi Dilaver Mezini, I prezantuar me cilesine e bleresit pas ofertes se bere nga ana e Bujar Frangut ortakut tjetër z.Alban Shehri dhe refuzimit te ketij te fundit per ti blere ato;sidhe kalimin e shoqerise ne shoqeri me tre ortake me kete pjesemarrje:

Alban Shehri 50% te kuotave

Dilaver Mezini 25% te luotave

Bujar Frangu 25% te kuotave.

Transferimi I kuotave eshte realizuar me kontraten e shitjes se kuotave me nr.3832/884 date 07.11.2006 te noterit Florian Hoxha.

Nisur nga sa me lart dhe nga teresia e provave cmohet se kerkesa dhe aktet jane konform Ligjit 7638 dt.19.10.1992 "Per Shoqerite Tregtare", ndaj si e tille, duhet pranuar.

PER KETE ARSYE

- Në bazë të Ligjit nr. 7638 dt.19.10.1992 "Per Shoqerite Tregtare", dhe te Ligjit nr. 7667, dt. 28.01.1993

VENDOSA

- Pranimin e kerkeses.

- Depozitim në zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të vendimit nr.1 datë 07.11.2006 të asamblese së ortakëve të shoqërisë "ALBAKONTROLL" shpk.
 - Depozitim e kontratës së shitjes së kuotave me nr.3832/844 datë 07.11.2006 të noterit Florian Hoxha.
 - Përfundimisht shoqëria "ALBAKONTROLL" shpk paraqitet me këtë pjesëmarrje ortakësh në kapitalin themeltar të saj:
 - Alban Shehri 50% të kuotave
 - Dilaver Mezini 25% të kuotave
 - Bujar Frangu 25% të kuotave.
- Urdhërimin e Zyrës së Regjistrimit Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë të bëjë ndryshimet në _____ të Regjistrimit Tregtar.

GJYQTARE

(Enkela Bajo)

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE "ALBAKONTROLL" SHPK.



NENI 1.

1. - **Z. Alban Shehri**, person fizik shqiptar, I biri I Fehmiut, lindur ne Tirane, me 16.02.1971, me adrese banimi, Rr.H. Kolli, Pallati Frateri, Ap. 9A, Tirane, me Pashaporte Nr. 1996980
 2. - **Z. Bujar Frangu**, person fizik shqiptar, I biri I Zenelit, lindur ne Burrel, me 03.02.1958, me adrese banimi, Rr.Mustafa Lleshi, Pall. 27/1, Ap. 8, Tirane me Pashaporte Nr. 0374029;
- Te nisur nga deshira e mire per te ushtruar aktivitet ekonomik, palet e mesiperme kane vendosur te themelojne një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin Nr.7638 dt. 19. 11. 1992 "Per shoqerite tregtare".

NENI 2.

Shoqëria vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe në përputhje me dispozitat e statutit që i bashkëlidhet këtij Akt Themelimi.

NENI 3.

Emri i shoqërisë është "**ALBAKONTROLL**" Shpk.

NENI 4.

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj:

Agjensi doganore, agjensi spedicionere dhe transporti, agjensi turistike, shërbim postar express, kontroll sasior dhe cilësor të mallrave, marrje perpunim mostrash, kryerje analizash kimiko-fizike, kontroll të pershtatshmerisese mjeteve të transportit magazinave dhe depove të magazinimit, kontroll amballazhi, marketimi, etiketimi dhe stivimi të mallrave.

NENI 5.

Qendra e shoqërisë është në qytetin e Tiranës. Ajo mund të hapë filiale apo dege në të gjitha rrethet e vendit si dhe jashtë tij.

Selia e shoqërisë është me adrese Rr. H. Kolli, Pallati Frateri, Ap. 9A, Tirane.

NENI 6.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte ne shumen 100'000 leke. Ai formohet nga derdhjet e kontributeve si me poshte:

1. Z. **Alban Shehri**, ka sjelle ne shoqeri nje kontribut me para ne shumen 50.000 leke dhe merr 50 pjese te kapitalit themeltar ose 50 % te saj, te renditura nga numri 1 deri ne 50.
2. Z. **Bujar Frangu**, ka sjelle ne shoqeri nje konrtibut me para ne shumen 50.000 leke dhe merr 50 pjese te kapitalit themeltar ose 50 % te saj, te renditura nga numri 51 deri ne 100.

Te gjitha pjeset qe formojne kapitalin themeltar, nenshkruhen plotesisht, pastaj shperndahen nepermjet ortakeve sipas ndarjes se mesiperme.

Bashkimi i te gjitha pjeseve te kapitalit themeltar ne nje dore te vetme nuk çon ne prishjen e shoqerise.

NENI 7.

Viti financiar, shpërndarja e fitimit të shoqërisë, punësimi, kompetencat, prishja e shoqërisë para kohe, likuidimi dhe kushtet e tjera përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 8.

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë kohe mbi 10 vjet.

NENI 9.

Ky Akt Themelimi është përpiluar në qytetin e Tiranës sot më dt. __/12/2003.

PER SHOQERINE "ALBAKONTROLL" SHPK.


ORTAKET

ALBAN SHEHRI

ALBAN SHEHRI



BUJAR FRANGU



STATUTI

I SHOQERISE "ALBAKONTROLL" SHPK

I. KRIJIMI, FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ALBAKONTROLL" Shpk. eshte krijuar sipas kontrates qe i bashkelidhet ky statut, te perpiluar dhe te nenshkruar nga:

1. - **Z. Alban Shehri**, person fizik shqiptar, I biri I Fehmiut, lindur ne Tirane, me 16.02.1971, me adrese banimi, Rr.H. Kolli, Pallati Frateri, Ap. 9A, Tirane, me Pashaporte Nr. 1996980;

2. - **Z. Bujar Frangu**, person fizik shqiptar, I biri I Zenelit, lindur ne Burrel, me 03.02.1958, me adrese banimi, Rr.Mustafa Lleshi, Pall. 27/1, Ap. 8, Tirane me Pashaporte Nr. 0374029;

Te dy palet e mesiperme kane rene dakort per te zhvilluar me vullnetin e tyre te lire veprimtari tregtare ne Shqiperi ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Palet kane hartuar si me poshte statutin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, te cilet u muarren vesh ta themelojne midis tyre.

NENI 2

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne Shqiperi ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe ne perputhje me dispozitat e ketij statuti.

Shoqeria fiton personalitetin juridik nga dita e regjistrimit te saj si person juridik.

NENI 3

Emertimi i shoqerise eshte "ALBAKONTROLL" SHPK.

NENI 4

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj:

Agjensi doganore, agjensi spedicionere dhe transporti, agjensi turistike, sherbim postar express, kontroll sasior dhe cilesor te mallrave, marrje perpunim mostrash, kryerje analizash kimiko-fizike,



kontroll te pershtatshmerisese mjeteve te transportit magazinave dhe depove te magazinimit, kontroll amballazhi, marketimi, etiketimi dhe stivimi te mallrave.

NENI 5

Qendra e shoqerise eshte ne qytetin e Tiranes. Ajo mund te hape filiale apo dege ne te gjitha rrethet e vendit si dhe jashte tij.

Selia e shoqerise eshte me adrese Rr. H. Kolli, Pallati Frateri, Ap. 9A, Tirane.

NENI 6

Shoqeria ka vulen e saj mbi te cilen ka te shkruajtur emrin e vet.

NENI 7

Kohezgjatja e shoqerise eshte percaktuar per nje periudhe mbi 10 vjet duke filluar nga dita e njohjes se personalitetit te saj si person juridik.

II. KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

NENI 8


Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 leke. Ai eshte i ndare ne 100 pjese ku nje pjese ka nje vlere prej 1,000 Leke te renditura nga numuri 1 deri ne 100, te cilat jane te shlyera plotesisht nga ortakët dhe te vertetuara nga nje dokument bankar.

Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet shtimit te pjeseve te saj, ortakët e shoqerise kane te drejte te rritjes se tyre ne menyre proporcionale.

NENI 9

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga derdhjet e kontributeve te meposhtme:

1. Z. **Alban Shehri**, ka sjelle ne shoqeri nje kontribut me para ne shumen 50.000 leke dhe merr 50 pjese te kapitalit themeltar ose 50 % te saj, te renditura nga numuri 1 deri ne 50.



Z. Bujar Frangu, ka sjelle ne shoqeri nje kontribut me para ne shumen 50.000 leke dhe merr 50 pjese te kapitalit themeltar ose 50 % te saj, te renditura nga numri 51 deri ne 100.

Te gjitha pjeset qe formojne kapitalin themeltar, nenshkruhen plotesisht, pastaj shperndahen nepermjet ortakeve sipas ndarjes se mesiperme.

Bashkimi i te gjitha pjeseve te kapitalit themeltar ne nje dore te vetme nuk çon ne prishjen e shoqerise.

NENI 10

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme, ndermjet ortakeve, me rruge trashegimie, ne raste ndarje pasurore mes bashkeshorteve dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

Pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen te treteve vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe zoterojne 3/4 e pjeseve dhe me kushte jo te me te favorshme se ato me te cilat ju jane afruar me pare ortakeve te tjere.

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohet me akt noterial.

III MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI, DHE KONTROLLI I SHOQERISE

NENI 11

Ortaket e shoqerise perballojne humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se tyre te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar.

Vendimet merren nga asambleja e ortakeve.

Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet dhe vendimet e asamblese dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

Çdo ortak ka te drejte te perfaqesohet ne keto mbledhje nga nje mandat mbajtes I cili mund te votoje ne emer te atij qe perfaqeson.

Mbledhja e asamblese mund te thirret nga çdo ortak qe zoteron mbi 1/10 e pjeseve te kapitalit themeltar, nga administratori, nga eksperti kontabel i autorizuar nga likujduesit.

Sipas rendesise se vendimeve, mbledhja e asamblese mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme.



Asambleja e zakonshme vendos me shumice absolute per ceshtje te tilla si, emerimin ose shkarkimin e administratorit, te ekspertit kontabel te autorizuar dhe likujduesve, miratimin e raporteve te administrimit dhe te kontrollit, miratimin e llogarive vjetore, te ndarjes e fitimit etj.

Asambleja e jashtezakonshme vendos per ceshtje te tilla si, ndryshimin e statutit, zvogelimin e pjeseve te kapitalit themeltar, zmadhimin e kapitalit themeltar, transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet, shnderrimin e shoqerise ne forma te tjera, mbylljen e shoqerise perpara kohe, zgjatjen e afatit kohor te shoqerise.

Vendimet e asamblese se jashtezakonshme merren nga ortaket qe perfaqesojne 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar.

NENI 12

Shoqeria administrohet nga administratore, qe duhet te jene persona fizik por mund te jene edhe ortak te shoqerise.

Ne mbledhjen e pare te asamblese eshte vendosur qe si administrator i vetem I shoqerise emerohet;

- **Z. Alban Shehri**, I biri I Fehmiut, lindur ne Tirane, me 16.02.1971, me adrese banimi, Rr.H. Kolli, Pallati Frateri, Ap. 9A, Tirane, me Pashaporte Nr. 1996980


Administratori emerohet dhe shkarkohet me miratimin e ortakeve qe zoterojne mbi 1/2 e pjeseve te kapitalit themeltar. Emerimi i tij behet per nje periudhe kohe prej tre vjetesh financiare me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose te shkarkimit te parakohshem.

Administratori ka te drejten e rizgjedhjes ne detyren qe ushtron.

Ne marredhenie me ortaket, administratori ka te drejten per te kryer te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj, nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise, me perjashtim te atyre rasteve (kompetencave) qe ligji dhe ky statut ja japin shprehimisht ortakeve.

Mbledhja e asamblese cakton vecmas kompetencat e secilit administrator ku shoqeria do te kete me shume se nje administrator.

Administratoret jane pergjegjes individualisht ose solidarisht sipas rastit ndaj shoqerise apo te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faje te tyre gjate administrimit te shoqerise.



NENI 13

Kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar i emeruar per tre vite financiare me mundesi rizgjedhjeje. Ata caktohen nga mbledhja e ortakeve qe perfaqesojne me shume se 1/2 e pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise.

Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejta kondita si emerimi, ne rast se behen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres.

NENI 14

Ortaket e shoqerise ne mbledhjen e tyre i delegojne administratorit edhe kompetenca te tjera nepermjet nje prokure te posacme ose te pergjithshme.

IV. VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE,NDARJA E FITIMIT.

NENI 15

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon ne ditën e regjistrimit si person juridik dhe perfundon me 31 Dhjetor te vitit te regjistrimit.

NENI 16

Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e veprimtarise se vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga asambleja me shumice absolute te ortakeve qe zoterojne mbi 1/2 e pjeseve te kapitalit themeltar.


Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore te shoqerise behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga dita e mbylljes se vitit financiar.

NENI 17

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria, mbasi zbriten te gjitha shpenzimet, si dhe fondet te lena rezerve, per nxitjen ekonomike, per investime, per reklamen tregetare etj. ndahen ndermjet ortakeve ne perputhje me perqindjen e pjeseve te kapitalit themeltar qe ka secili ortak.

NENI 18

Bilanci vjetor i shoqerise nxiret brenda 31 Marsit te vitit pasardhes.



NENI 19

Shoqëria ka te drejten e perdorimit e te disponimit te pasurise se saj ne perputhje me qellimin e objektit te veprimtarise qe kryen.

NENI 20

Shoqëria gezon te gjitha te drejttat dhe mbrojtjen e pasurive te saj nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

NENI 21

Detyrimet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqërise, ajo i mbulon nga fondi rezerve, fondet e tjera ose nga shumat suplementare qe mund te derdhen ortaket.

V. PUNESIMET NE SHOQËRI.

NENI 22

Per punonjesit qe do te punesohen, maredheniet juridike midis shoqërise dhe te punesuarve do te regullohen nepermjet kontrates se punes dhe te dispozitave ligjore ne fuqi.

NENI 23

Shoqëria merr persiper te bej sigurimin e te punesuarve prane saj, ne organet kompetente perkatese duke derdhur regullisht kontributet ne perqindjen sipas percaktimeve te vendosura ne dispozitat ligjore ne fuqi.

VI. PRISHJA E SHOQËRISE DHE LIKUIDIMI.

NENI 24

Shoqëria priset para kohe kur:

- aktiviteti ekonomik i saj per nje kohe te gjate rradhazi eshte ne humbje.
- per arsye te parashikuara me ligj.
- me vendim te jashtzakonshem te asamblese se ortakeve.



NENI 25

Shoqëria nuk prishet kur njeri nga ortakët, falimenton, behet i paaftë ose vdes.

NENI 26

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, asambleja emeron një ose disa likuidator, të cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatin e nevojshëm të perfundimit të tyre.

NENI 27

Mbas pagimit të kreditorëve, shlyerjen e të gjitha detyrimeve dhe shlyerjen e pjesëve të kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndërmjet ortakëve, proporcionalisht me pjesët që ata zoterojnë.

VII. DISPOZITAT E FUNDIT.

NENI 28

Shnderimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera si, kolektive, komandite apo anonime, behet me vendim të asamblese së jashtëzakonshme të ortakëve.

NENI 29


Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent për shqyrtimin e tyre është Gjykata e Faktit Tirane.


NENI 30

Të gjitha vendimet e shoqërisë regjistrohen në një liber të vecantë që mbahet në selinë e shoqërisë.

NENI 31

Ky statut është hartuar në qytetin e Tiranës në pesë ekzemplare, sot me datën, 12.12.2025





PER SHOQERINE "ALBAKONTROLL" SHPK.

ORTAKET

ALBAN SHEHRI

ALBAN SHEHRI

BUJAR FRANGU

Bujar Frangu
[Signature]

REPUBLIKA E SHOQERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR. 8623 REP.
NR. 5014 KOL.

[Signature]

VERTETIM

Sot, më dt. 19 / 12 / 2004, para meje, noteres, u paraqiten personalisht Ortaket e shoqërisë "ALBAKONTROLL" Shpk, Z. Alban Shehri, I datelindjes 16.02.1971 dhe, Bujar Frangu, I datelindjes 03.02.1958, madhor, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, për identitetin e te cileve u sigurova nga Pashaportat qe mbanin me nr. 1996980 dhe nr. 0374029, te cilet më deklarojne se kane hartuar jashte kesaj zyre akt-themelimin dhe statutin e kesaj shoqerie dhe e nëshkrojne atë rregullisht para meje dhe, unë Notëre e vërtetova atë sipas ligjit.



NOTERE NOTERE
SHKENDIE SHAHU
CEL: 069 21 44 865

[Signature]

[Signature]

[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES

Nr.3833 Rep

Nr 845 Kol

VERTETIM

Sot me date 07.11.2006(Dymije-gjashte) para Meje **Noterit Florian Hoxha**, regjistruar ne Dhomen e Notereve Durres, me zyre Noteriale prane Gjykates se rrethit Durres u paraqit **Administratori i Shoqerise "Albakontroll" sh.p.k.** me qender ne Tirane **Z.Alban Shehri** , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u njoha ne baze te ligjes, pranoi se eshte dakort me Kerkesen drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqsor Tirane per depozitim aktesh te Shoqerise tregtare, nenshkruajti ate para Meje me vullnet te Lire dhe Une Noteri vertetoi autenticitetin e nenshkrimeve te tij .

UNE NOTERI VERTETOJ.

NOTERI
FLORIAN HOXHA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
Nr 3831 Rep
Nr 843 Kol



DEKLARATE - NOTERIALE

Sot me date 07.11.2006(Dymije e gjashte), para Meje noterit florian Hoxha me zyre Noteriale prane Gjykates se Rrethit Durres u paraqit shtetasi i meposhtem dhe konkretisht:

Z.Alban Shehri i biri i Fehmiut i dl.16.02.1971, lindur ne Tirane dhe banues ne rrugen "H.Kolli, Pallati Frateri, Ap.9a-Tirane, me zotesi te plote per te vepruar, per identitetin e te cilit u njoha ne baze te pashaportes me nr.1996980.

I cili me deklaroi si me poshte:

Une **Alban Shehri** prezantuar me cilesine e njerit prej Orakeve te Shoqerise "AlbAKONTROLL" Sh.p.k. dhe njekohesisht me cilesine e Administratorit te Saj deklaroj me deshire dhe vullnet te lire se pasi jam njohur me oferten e bere nga Ortaku tjetër i Shoqerise Z.Bujar Frangu per blerjen e 25% kuotave te Tij, deklaroj se refuzoj blerjen e tyre.

Deklaraten e mesiperme pasi e lexova e pranova dhe e nenshkruajta me deshire dhe vullnet te lire....

Une Noteri Vertetoj

Deklaruesi

Alban Shehri

NOTERI
Florian HOXHA

SHOQERIA "ALBAKONTROLL" Sh.p.k.
TIRANE
VENDIM Nr.1



ORTAKEVE TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ALBAKONTROLL" Sh.p.k.

Me Vendimin Nr 32640 te dates 24.12.2004 te Gjykates se Rrethet Gjyqsor Tirane eshte bere regjistrimi si Person Juridik I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "Albakontroll" sh.p.k. ne adrese:Rruga "H.Kolli", Pall.Frateri, Ap.9A-Tirane me dy ortak dhe administrator **Z.Alban Shehri**.

Ne seline e Shoqerise "**ALBAKONTROLL**" sh.p.k. Ortaket e Shoqerise **Z.Alban Shehri** dhe **Z.Bujar Frangu**, si rezultat I analizes te bere nga ana e tyre te aktivitetit ekonomik te deritanishem te shoqerise.

VENDOSEN

1) Shitjen e 25% te kuotave te Kapitalit themeltar te njerit prej Ortakeve te Saj **Z.Bujar Frangu** shtetasit **Z.Dilaver Mezini** prezantuar me cilesine e blesesit me banim ne lagjen nr.13-Plazh-Durres pas ofertes se bere nga ana e **Z.Bujar Frangu** ortakut tjetër te Shoqerise **Z.Alban Shehri** dhe refuzimit te ketij te fundit per ti blere ato, dhe qe nga ky moment shoqeria perbehet me tre Ortake me kete pjese marje ne kapital themeltar si me poshte:

Z.Alban Shehri me 50% te kuotave te kapitalit te shoqerise
Z.Dilaver Mezini me 25% te kuotave te kapitalit te shoqerise.
Z.Bujar Frangu me 25% te kuotave te kapitalit te Shoqerise

ORTAKET E SHOQERISE "ALBAKONTROLL" sh.p.k.

Alban Shehri *Bujar Frangu*
[Signature] *[Signature]*

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES

Nr 3830 Rep
Nr 842 Kol

VERTETIM


Sot me date 07.11.2006(Dymije e gjashte) para Meje Noterit **Florian Hoxha**, regjistruar ne Dhomen e Notereve Durres, me zyre Noteriale prane Gjykates se shkalles se pare Durres u paraqiten shtetasit **Alban Shehri** me cilesine e njerit prej Ortakeve te Shoqerise dhe njekohesisht Administrator i Saj dhe **Z.Bujar Frangu** me cilesine e ortakut tjetër te Shoqerise, me zotesi te plote per te vepruar, per identitetin e te cileve u njoha ne baze te ligjes, te cilet deklaruan se jene dakort me permbajtjen e Vendimit te Asamblese, nenshkruajten me vullnet te lire para Meje dhe Une Noteri vertetoj autenticitetin e nenshkrimite tyre....

UNE NOTERE VERTETOJ.

NOTERI
FLORIAN HOXHA

[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
Nr. 3832 Rep
Nr. 844 Kol



KONTRATE - SHITJE - KUOTASH

Sot me date 07.11.2006(Dymije e gjashte), para **meje Noterit Publik Florian HOXHA**, me zyre Noteriale prane Gjykates se Rrethit Durres u paraqiten personalisht Ortaket e Shoqerise " Albakontroll" sh.p.k. me qender ne Tirane:

1-Bujar Frangu, i biri i Zenelit i dl.03.02.1958, banues ne Tirane, ne rrugen " Mustafa Lleshi", pall.27, me zotesi te plote per te vepruar, per identitetin e te cilit u njoha ne baze te Pasaportes me Nr.Z1352892

me cilesine e SHITESIT

1) **Dilaver Mezini I** dl 20.03.1953, lindur ne Tirane dhe banues ne lagjen nr.18-Durres, Rruga"A.Goga", me zotesi te plote per te vepruar, me identitet me Pasaportes me Nr.Z0330232.

Me cilesine e **BLERESIT**

Palet me kerkuan redaktimin e kesaj Kontrate Shitje - Kuotash si vijon:

Shoqëria Tregtare "Albakontroll"sh.p.k.me qender ne Tirane ne adrese: rruga"H.Kolli, pall.Frateri, ap.9A-Tirane, eshte rregjistruar në Rregjistrin Tregëtar Tiranë, me vendimin gjyqësor, nr.32640, dt.24\12\2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë, me objekt:
Hapjen e Agjensive Doganore, agjensi spedicioniere dhe transporti, agjensi turistike, sherbim postar ekspres, kontroll sasior dhe cilesor te mallrave, marrje perpunim mostrash, kryerje analizash kimiko-fizike, kontroll te pershtateshmerise se mjeteve te transportit magazinave dhe depove te magazinimit, kontroll amballazhimi, marketimi, etiketimi dhe stivimi te mallrave.

Me Vendimin Nr.1 date 06.11.2006 te Asamblese se Ortakeve, pas Ofertes se bere nga njeri prej Ortakeve te Saj **Z.Bujar Frangu** per shitjen e 25% te kuotave te kapitalit Themeltar te Shoqerise, Ortakut tjeter **Z.Alban Shehri** dhe refuzimit nga ana e ketij te fundit, eshte vendosur shitja nga ana e Z.Bujar Frangu te 25% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise Bleresit **Z.Dilaver Mezini** me banim ne lagjen Nr.13-Plazh-Durres.

Z.Dilaver Mezini, prezantuar ne kete kontrate Shitje Kuotash me cilësinë e blerësit, pranon të blejë 25% të kuotave të Z.Bujar Frangu prezantuar me cilesine e njerit prej Ortakeve te Shoqerise Tregtare "Albakontroll" sh.p.k. me seli ne Tirane, dhe kjo Shoqeri do te perbehet me tre Kuotake me pjesemarrje ne kapital themeltar si me poshte:

Z.Alban Shehri me 50% te kuotave te kapitalit te Shoqerise.

Z.Dilaver Mezini me 25% te kuotave te kapitalit te Shoqerise.


Z.Bujar Frangu me 25% te kuotave te kapitalit te Shoqerise.

• Me realizimin e kësaj Kontrate shitje-bletje të kuotave të njerit prej Ortakeve te Shoqerise Tregtare "Albakontroll"sh.p.k. me seli ne Tirane, dhe regjistrimit të këtij veprimi juridik në Gjykatën e Rrethit Gjyqsor Tirane, shitësi detyrohet që këtë veprim ta pasqyrojë në ndryshimet që duhet të bëjnë në Aktin e Themelimit dhe në Statutin e Shoqërisë Tregtare "Albakontroll" sh.p.k.


Per sa me siper, pasi e lexuan dhe e gjeten te rregullt Kontraten e Shitje - Blerjes se Kuotave, nenshkruan ate para Meje, me vullnet te Lire.

UNE NOTERI VERTETOJ


SHITESI



BLERESI



NOTERI
FLORIAN HOXHA



32640

S B Mucos
24 DHETOR 2004

K E R K E S E

KERKUESI:

Z. Alban Shehri, I me cilesin e Administratorit te shoqerise "ALBAKONTROLL" Shpk Tirane.

OBJEKTI:

Kerkoj regjistrimin e shoqerise "ALBAKONTROLL" Sh.p.k., si person juridik ne Regjistrin Tregtar.

RAZAT LIGJORE:

Neni 19 I ligjit nr.7632 dt.04/11/1992, Neni 33 I Ligjit nr.7667 dt.28.01.1993 dhe ligji nr.7638 dt.19.11.1992.

G J Y K A T E S E S E F A K T I T

T I R A N E

Shoqeria "ALBAKONTROLL" Sh.p.k Tirane me kapital themeltar 100.000 leke, eshte e themeluar nga Ortaket : Z. Alban Shehri, me 50 % dhe Z. Bujar Frangu, me 50 % .

Shoqeria eshte:

- me Administrator te vetem Z. Alban Shehri, I biri I Fehmiut, lindur ne Tirane, me 16.02.1971, me adrese banimi, Rr.H. Kolli, Pallati Frateri, Ap. 9A, Tirane, me Pashaporte Nr. 1996980
- me kohezgjatje mbi 10 vjete,
- me seli ne qytetin e Tiranës me adrese Rr.H. Kolli, Pallati Frateri, Ap. 9A, Tirane,
- me objekt veprimtarie:

Agjensi doganore, agjensi spedicionere dhe transporti, agjensi turistike, sherbim posta express, kontroll sasior dhe cilesor te mallrave, marrje perpunim mostrash, kryerje analizash kimiko-fizike, kontroll te pershtatshmerisese mjeteve te transporti magazinave dhe depove te magazinimit, kontroll amballazhi, marketimi, etiketimi dhe stivimi te mallrave.

Sa me siper ne mbeshtetje te nenit 33 te ligjit nr.7667 dt.28.01.1993 dhe te ligjit nr. 7638 dt.19.11.1992, "Per shoqerite tregtare", I kerkoje Gjykates qe te regjistroj shoqerin "ALBAKONTROLL " Shpk Tirane si person juridik me qellim qe te mos kem asnje pengese ligjore per te vepruar.

Tirane me, /12/2004

ADMINISTRATORI

Alban SHEHRI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR. 8629 REP.
NR. KOL.

V E R T E T I M

Sot, me dt. 14 / 12 / 2004, para meje,noteres, u paraqit personalisht Administratori i shoqerise "ALBAKONTROLL" Shpk , z. Alban SHEHRI, i datelindjes 16.02.1971, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e tij u sigurova nga pashaporta personale qe mbante me Nr. 1996980, i cili me deklaroi se eshte dakort me kerkesen e mesiperme dhe e nenshkroi ate rregullisht dhe une Notere e vertetova ate sipas ligjit.



NOTERE
SHKENDRE SHAHU
CEL: 069 21 44 865

Handwritten signature

MA. i Proccuar
Banc
Nr. llogj 1044842
28.12.00-01
dt 23.12.04
Act received
Statuto FIN
14-12-04



32640/1

SHOQERIA TREGTARE "ALBAKONTROLL" SH.P.K.
TIRANE

KERKESË

KERKUESI : Z. Alban Shehri, Administrator i Shoqërise "Albakontroll" sh.p.k.
me Selë ne adresë: Rruga "H.Kolli", pallati Frateri, Ap.9A-Tirane .

ME OBJEKT

- 1- Kërkesë, depozitimi i Vendimit Nr.1 datë 06.11.2006 të Ortakeve të Shoqërise "Albakontroll" Sh.p.k. me qendër në Tiranë.
- 2- Depozitimi i Kontrates së Shitblerjes së Kuotave.
- 3- Depozitimi i Deklaratës Noteriale.

GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR

TIRANE


Ju parashtrojmë se Shoqëria "ALBAKONTROLL" sh.p.k. me qendër në Tiranë, është regjistruar si person Juridik nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin Nr.32640 datë 24.12.2004, në adresë: Rruga "H.Kolli", pallati Frateri, Ap.9A-Tiranë .

Sikurse është parashtuar në Vendimin nr.1 datë 06.11.2006 të Ortakeve të Shoqërise "Albakontroll" sh.p.k me qendër në Tiranë është vendosur:

- 1) Shitjen e 25% të kuotave të kapitalit themeltar të njerit prej Ortakeve të Saj **Z.Bujar Frangu** shtetasit **Z.Dilaver Mezini** prezantuar me cilesinë e blesësit me banim në lagjen Nr.13-Plazh-Durrës pas ofertës së bere nga ana e Z.Bujar Frangu ortakut tjetër të shoqërise Z.Alban Shehri dhe refuzimit të ketij të fundit për të blere ato dhe kalimin e shoqërise me 3(tre) ortakë me këtë Pjesëmarrje:

Z.Alban Shehri nga 50% të kuotave të kapitalit shoqërise
Z.Dilaver Mezini me 25% të kuotave të kapitalit të shoqërise
Z.Bujar Franu me 25% të kuotave të kapitalit të shoqërise.

Per sa parashtrova me sipër kerkoj nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të marrë në shqyrtim kerkesen time dhe në baze të ligjit Nr. 7638 datë 19.11.1992 " për shoqërite Tregtare" dhe Ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar" të vendoset.



- 1) Pranimitimi i kërkesës së Administratorit të Shoqërisë " ALBAKONTROLL"
sh.p.k.Z.Alban Shehri
- 2) Depozitimi pranë zyres së Regjistrimit Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të
Vendimit Nr.1 datë 06.11.2006 të Ortave të Shoqërisë " Albakontroll" sh.p.k. për
përkrahje shitjeje të Kuotave.
- 3) Depozitimi i Kontrates së Shitblerjes së Kuotave Nr.3832 Rep dhe Nr.844 kol datë
07.11.2006.
- 4) Depozitimi i Deklaratës Noteriale Nr.Rep 3831 dhe Nr.843 Kol datë 07.11..2006.

Bashkëngjitur dokumentet përkatëse.

KERKUESI

Administratori i Shoqërisë :
Z.Alban Shehri

